

# BESIMTARI

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkoder  
Vitet I i botimit, Shtator 2007 Nr 5. Çmimi 20 lekë. www.gazetabesimtari.com



## GEZUAR *R*amazanin 1428/2007

MIRE SE ERDHE MUAJI  
I MADHNUESHEM  
I RAMAZANIT  
*H. Bashkim Bajraktari*  
Fq 2

KATASTROFAT NATYRORE  
VËREJTJE PËR  
NJERËZIT E MENÇUR  
*Nexhat Ibrahim*  
Fq 3

RILINDJA FETARE  
*Faik Miftari*  
Fq 4

VITI ORVELLIAN I  
ISMAIL KADARESE  
*Olsi Jazexhi*  
Fq 5

HIXHABI ESHTË OBLIGIM  
PER MOTREN MUSLIMANE  
*Kasem Zylja*  
Fq 6

NE VITET 90 BOSNJA U  
BE ARENE E PERDHUNIMEVE  
MASIVE ...  
*Selim Gokaj*  
Fq 7

## ABDULLAH GYL PRESIDENTI I RI I TURQISE



Tashmë, Turqia e ka presidentin e saj. Ai është Abdullah Gyl, ish- ministri i suksesshëm i qeverisë së kryeministrit Erdogan i cili, për aftësië e padiskutuëshme si diplomat, e propozoi në emër të partisë fituese në zgjedhje e fundit parlamentare .ku ajo fitoi besimin e popullit turk permes një mbështetjeje masive që ai i bëri me votat e tij . Abdulla Gul është një ndër figurat kryesore të partisë Për Drejtësi dhe Zhvillim , një figurë shumë e rëndësishme e diplomacisë Turke, i cili, në pozitën e ministrit të jashtëm në qeverinë paraardhëse, bëri hapa të rëndësishëm për ta afruar Turqinë ne BE. përmes negociata të suksesshme me diplomacinë evropjane. Në Turqi, Abdulla Gyl është i njohur si një politikan karizmatik i cili gëzon një popullaritet të jashtzakonshëm në rrallët dërmuese të popullit turk . Ai ishte një figure tepër e rëndësishme që luajti një rol të padiskutuëshëm në fitoren e partisë Për Drejtësi dhe Zhvillim .Flitet, në mediat turke, se ishte një elektorat i madh që votoi për partinë fituese i cili u mbështetën në fushatën e mrekullueshme që bëri Abdulla Gyl me stafin e tij elektorat.. Duke fituar me 339 vota në zgjedhjet që u bënë në parlament, thauajse mbi 100 vota më shumë së shifra optimale për t,u zdhedhur president, Abdulla Gyl tregoi se ishte kandidati më i kompletuar dhe më i mbështeturi për

t,u bërë kryetar i shtetit turk. Popuj dhe shtete që e nderojnë Turqinë dhe duan që ky shtet të jetë pranë shteteve më të fuqishëm dhe më të përparuara , e përshëndetët zgjedhjen e presidentit Abdulla Gul ,si një figurë që do të jetë zëri i të gjithë popullit turk duke mbrojtur interesat kombëtare të Turqisë në këtë botë të trazuar, ku pa tjetër edhe Turqia po penalizohet për popullsinë dominante muslimane ,duke i vënë një mal me pengesa, me synimin për ta mbajtur sa më larg klubit të krishterë evropjan ,siç e quante ish -kryeministri turk Mesut Illmaz Bashkim Evropian. Por, kampi që nuk ishte dakort me fitoren e presidentit të ri të Turqisë ,vuri me shpejtësi në lëvizje mediat e tij të fuqishme të cilat u bënë cope të zbehin dhe të ulin vlerat e presidentit të ri të Turqisë, Abdulla Gyl.. Ato, permes mediave të financuara., pa tjetër prej tyre, krijuan "Nje themër Akili" artificilale për presidentin e ri të Turqisë, e cila ,për armiqt e shpallur dhe të pashpallur të Turqisë ishte e kaluara islamike e Abdulla Gylit , thauajse bëhej fjalë për një të kaluar kriminale të tij. Mediat më të fuqishme ndërkombëtare e paraqitën presidentin e ri si një islamik radikal , sikur në Turqi pushtetin e kanë marrë radikalët islmikë, që janë një me ato që, për interesa të veta

Vijon në fq 3

# MIRE SE ERDHE MUAJI I MADHNUESHEM I RAMAZANIT

Kur Allahu xh. sh ia do të mirën një besimtari i jep atij mundësi të jetojë gjatë dhe të kryej vepra të mira. Në veçanti, muaji i Ramazanit është momenti kur Allahu xh. sh. është një dhurues i madh për besimtarët që e adhurojnë atë.

Muaji i madhnueshëm i Ramazanit është muaji i mirësisë, muaji i ibadeteve, muaji, kur besimtarët muslimanë sakrifikojnë për hir të Allahut xh. sh. , muaji, kur besimtarët muslimanë e rrisin përkushtimin tyre ndaj fesë islame, kusht ky kaq i rëndësishëm për këto kohë të rënda që po kalojnë muslimanët në të gjithë hapësirat ku ato jetojnë sot. Është kënaqësi, kur njeriu shikon se në ambjete familjare, ambjete shoqërore dhe kudo ku janë prezent muslimanë, tema kryesore e bisedës është Ramazani i madhnueshëm që po troket në dyert tona. Agjërimi i Ramazanit është bërë pjesë e rëndësishme e jetës së besimtarëve muslimanë ku nuk bëjnë përjashtim as të vegjëlit që janë brezi i rii besimtarve muslimanë për të ardhmen. Brezat e pare, në kohën e profetin A. s. dhe pas tij, e prisnin Ramazanin 6 muaj përpara dhe, kur Ramazani vinte, ato thonin: "Mirë se erdhe o pastrues", duke nënkuqëptuar se Ramazani i ndihmon njerëzit të largohen nga gjynahet. Të gjithë besimtarë muslimanë kanë nevojë të marrin shembull nga brezat e pare, sepse besimtari duhet të matet me ato që janë më lart shpirtërisht si fetarë se ai. Muaji i Ramazanit është krejt ndryshe nga muajt e tjerë, sepse ai është një rast ideal për pastrimin tone shpirtëror dhe janë besimtarët muslimanë ato që përgaditen materialisht, shpirtërisht dhe moralisht që të jenë pjesë e kësaj festeje të madhe islame, siç është muaji i madhnueshëm i Ramazanit. Është ky muaj i veçantë për besimtarët, që u jep atyre rastin të tregojnë vlerat e besimit dhe përkushtimin të tyre ndaj Krijuesit të. Qëllimi i agjërimit të muajit të Madhnueshëm të Ramazanit është të bëhemi më të devotshëm gjë që theksohet edhe tek fjala e Allahut xh, sh. që në Kur-anin i Madhnueshëm thotë: "O ju që keni besuar, ju është bërë obligim që ju të agjëroni, sikurse ishte obligim për ato popuj para jush, në mënyrë që të bëheni të devotshëm (Bakare 183) Qëllimi kryesor i devotshmërisë së kërkuar nga ne, është triumfimi mbi egon (nefsin), i cili nxit për ligësi. Profeti a. s. e ka quajtur xhihadin ndaj nefsit si shkallën më të lartë të xhihadit dhe po kështu ka thenë edhe për muajin e madhnueshëm të Ramazanit, ku xhihadi duket tek vëllazëria, bamirësia, falja, durimi dhe tregues të tjerë që i rrisin vlerën figurës së muslimanit gjatë muajit të madhnueshëm të Ramazanit

Sakrifica e besimtarit për t, u ndaluar nga ushqimi, pija dhe duhani janë në funksion të lartësimit shpirtëror të besimtarit, sepse këto sjellin kalori, të cilat, kur janë me shumicë, orjentohej nga kahu negativ, duke nxitur ligësitë që ulin figurën e besimtarit.

Besimtari e ka obligim që, në muajin e madhnueshëm të Ramazanit të rrisë përkushtimin ndaj Allahut të Madhnueshëm duke lexuar Kur-anin, sepse në këtë muaj ka filluar zbritja e Kur-anit Famëlartë. Në muajin e madhnueshëm të Ramazanit, vlerat e namazit nafile janë të barabarta me një namaz jashtë Ramazanit. Kur afrohej muaj i Ramazanit Profeti a. s. porosiste: "O njerëz! U afrua muaji i Ramazanit, muaji i madhnueshëm i bereqetit, i lumturisë dhe i përparimit, muaji në të cilin ndodhet Nata e Kadrit, që është më e vlefshme se 1000 muaj së bashku. Allahu ju ka urdhëruar të agjëroni çdo ditë, kurse netët e tij t, i kaloni në ibadete nafile. Kush fal nafile në Ramazan, është sikur të fal farz në ndonjë muaj tjetër. Kush fal farz në Ramazan, është sikur të fal 70 farze në një muaj tjetër. Ramazani është muaji i durimit, shpërblimit dhe xhenetit (Transmeton Ibnu Husejn)

Ka shumë rëndësi që besimtari të mos agjërojë për opinjon. Agjërimi duhet të bëhet vetëm për hir të Allahut dhe pengesat artificiale për t. i ikur agjërimit të Ramazanit, janë dukuri të përkushtimit difiçitar të një besimtari.

Për ata që kanë harruar zotin, Ramazani do t, u kujtojë kontratën me shpirtërat e tyre që e kanë lidhur që në Ezel me krijuesin e tyre. Kush e ka humbur durimin, Ramazani do t, ua kthejë atë të shumfishuar. do t, ua kthejë qëndrueshmërinë një shkallë shumë të lartë.

Muaji i madhnueshëm i Ramazanit është ai që do të bëjë që të fitojë në shoqërinë e muslimanëve bashkëpunimi, solidariteti, ndihma reciproke, që duhet të karakterizojë gjithmonë bashkësinë muslimane.

Rëndësi shumë të madhe ka që në këtë muaj të madhnueshëm të agjërojmë me gojë, me gjymtyrë, duke u larguar nga gibeti, të agjërojmë me sy, duke u larguar nga shikimet haram. Po nuk respektoam treguesit e më sipërm, agjërimit ynë do të jetë jo i kompletuar dhe do të jetë i mangët. Profeti a. s. na porositi se agjërimit nuk do të thotë që të largohesh nga ushqimi dhe pija, por do të thotë që të largohesh nga fjala e keqe dhe vepra e shëmtuar. Profeti ynë i nderuar na kujton se Allahu nuk ka nevojë për njeriun që e braktis ushqimin dhe pijen dhe nuk e braktis fjalën e keqe dhe veprën e ligë. Besimtarët duhet të falenderojnë Allahun xh. sh për këtë mundësi që u jep atyre përmes muajit të Madhnueshëm të

Ramazani, që ata ta shfrytëzojnë këtë muaj të madhnueshëm që të fisnikrohen edhe të falin të tjerët, kur ka mundësi, dhe të përgaditen të marrin shpërblimet për punët e mira që kanë bërë, të cilat Allahu xh. sh i ka të pakufizuara.

Lusim Allahun e Madhnueshëm që ky Ramazan, që tashmë ka trokitur në derën tone, t, i gjejë besimtarët muslimanë të lidhur fort pas fesë islame, larg egoizmit dhe ambicjes nga arritjet e besimtarëve të tjerë, sepse të gjithë muslimanët janë dhe mbeten vëllezër, ku të përjashtuar janë ato që përpiqen të pengojnë ecjen përpara të çështjes së çështjes së muslimanëve në të gjithë hapësirat ku ato jetojnë.

**Haxhi Bashkim Bajrajtari**  
Shkoder, me 1 Shtator 2007



## LOTI I TOBES

*Shoku ma i mire asht loti n'vetmi  
Kur, sexhden e tobës je vetum ti.  
Para Allahut në heshtje qëndron  
Nga mëshira e Allahut falje kërkon.  
Qetësi dhe prehje gjen n,at midis  
Me rahmetin e Tij Allahu e qindis..  
E ti njeri kurr mos u kurse  
Te dera e Allahut në heshtje kthe!  
Se cilësi e saj asht n,dorën e Tij  
Vetum tobja mundet ta arrij.  
Kur në errësirën e natës falje kërkon  
Allahu këndaqet kur falje kërkon.  
Të gjithë meleqet rrijn me nderim  
Robit pendues i ofrojn shërbim.  
Kënaqësi e madhe gjithshka përshkon  
Se robi gjyhnaqar mëshirë kërkon..  
Nga askush tjetër ai nuk e pret  
Po vetum e vetum nga Zoti i vet.  
Para madhnis s, Allahut çdo front shkrihet  
Robi i devotshëm lart e ma lart ngrihet.  
Lotët e tobës lidhi me Rahmanin  
Të lutem o Allah ,mëshiroje Burhanin!  
Fale mëshirën tande prindve të mij  
Dashurinë ndaj teje m,rrenjosen n, fmini.  
Ummetin musliman, e mbar njerzimin  
Se pa mëshirën tënde se gjejm udhëzimin.  
Rahmetek, ja Rabul alemin!  
Të gjith, s, bashku themi: Amin*

**Berhan Fili**

Miami, Florida ,me 10 Gusht 2007

### Urim me rastin e Muajit të Madhnueshëm të Ramazanit

Shoqata Bamirëse Islame Shkodër, Shoqata e intelektualëve "Kultura Islame" dega Shkodër, Forumi Musliman Shqiptar dhe Klubi "Drita, në emër të anëtarësisë që përfaqësojnë u urojnë besimtarëve muslimanë në Shkodër dhe më gjerë: "Për shumë vjet dhe Gëzuar Muajin e Madhnueshëm të Ramazanit". Urojmë që Allahu xh.sh. t'u dhurojë besimtarëve muslimanë një agjërimit të lehtë. Dëshirojmë që ky muaj të jetë një muaj fetar i rëndësishëm për forcimin e unitetit në radhët e besimtarëve muslimanë.

Shkodër, më 03.09.2007

**Shoqata Bamirëse Islame Shkodër,**  
**Shoqata e intelektualëve "Kultura Islame" - Shkodër,**  
**Forum Musliman Shqiptar**  
**Klubi "Drita"**

# Katastrofat natyrore vërejtje për njerëzit e mençur



Viteve të fundit bota po ballafaqohet me katastrofa të ndryshme natyrore: termete të mëdha shkatërruese, erëra të jashtëzakonshme, vërshime të shumta, vapa të papërballueshme, paraqitje të sëmundjeve të ndryshme të panjohura të njerëzit dhe të kafshët e bimët, luftëra të shumta dhe vdekja e njerëzve të pafajshëm etj. Etj. Ndër zonat më të dëmtuara janë vendet dhe popullsia muslimane. Shkencëtarët thonë se gjera të tilla ndodhin njëherë në disa shekuj. Ata këto ndodhi ia përshkruajnë faktorëve të ndryshëm, sikurse ngrohjes globale, ndeshjes së pllakave kontinentale, prishjes së shtresës së ozonit, etj.. Lidhur me këtë gjendje hazreti Aliu r.a. thotë:

*“Ndëshkimi nuk do të ndodh përveç për mëkat dhe ndëshkimi nuk do të hiqet përveç me pendim.”*

Pajtimi i muslimanëve me të këqijat rreth tyre, pjesëmarrja në mëkate dhe indiferenca e përgjithshme për ta penguar të keqen, tërheq përgjegjësinë dhe sprovat nga Allahu i madhërisëm:

*“Edhe ata që ishin para tyre vënë intriga. Po All-llahu rrënoi themel ndërtime të tyre (intrigat)*

*dhe kulmi u shemb mbi ta, dhe ashtu u erdhi dënimi kah nuk kuptuan.”* (En-Nahl, 26). Çudia e Cunamit në Azinë Juglindore, shtrëngatat rrënuese në SHBA dhe në kontinentin amerikan, janë vetëm një pjesë nga e vërteta e Allahut:

*“Neve nuk na pengoi asgjë që t'u sjellim argumente (mrekulli), pos asaj që ata të parët i përgënjeshtruan ato. Ne i dhamë Themudit devenë (mrekulli) konkrete, e ata e mohuan atë. E mrekullitë (ose fenomenet natyrore që shkatërrojnë), Ne nuk i dërgojmë për tjetër vetëm për frikësim.”* (El-Isra', 59).

Viktimat dhe rrënimet nëpër pjesë të ndryshme të botës, sidomos nëpër vendet muslimane, tregojnë se duhet të ruhemi që me sjelljet tona mos ta sfidojmë dënimin e Zotit, sepse ajo vjen fuqishëm dhe pa paralajmërim:

*“A mos u siguruan banorët e fshatrave nga dënimi jonë kur ata ishin fjetur (natën)? A mos u siguruan banorët e fshatrave nga dënimi jonë para dite kur ata ishin duke luajtur? A mos u siguruan ata prej ndëshkimit të All-llahut? Nuk sigurohet kush prej frikës së ndëshkimit të All-*

*llahut pos njerëzve të humbur.”* (El-A'râf, 97-99).

Kur në kohën e Omerit r.a. ndodhi një termet në Medinë, ai e mblodhi popullin dhe tha: *“O njerëz, nëse këtu sërish ndodh termeti, unë do të shkoj nga mesi juaj!”*

Vërejtja e Omerit r.a. ishte se të gjithë besimtarët duhet ta rregullojnë jetën dhe dhe sjelljet e tyre në pajtim me udhëzimet e ndritshme.

Në këtë jep shenjë edhe porosia e Muhammedit a.a., të cilën e transmeton Ebu Hurejre r.a.:

*“Muhammedi a.s. tha: Dita e kijametit do të ndodh kur të humbet dija (fetare), kur shpeshohen termetet, kur të kalojë koha shpejtë, kur të shpeshohen sprovat, kur të ndodhin vdekje të pakontrolluara (herxh) të njerëzve të pafajshëm dhe kur të ketë aq pasuri sa ajo do të jetë tepriçë në botë.”* (Buhariu).

Shumë njerëz kanë mbetur pa asgjë. Shumë fshatra dhe qytete janë zhdukur apo dëmtuar tej mase, Vendbanimet dhe fushat pjellore janë mbuluar me baltë, rërë dhe ujë. Popullsia nuk ka ujë të pijshëm, ushqim dhe veshmbathje.

Përpiqen t'i gjejnë më të dashurit e tyre dhe t'i varrosin. Muslimanët janë viktimat më të shpeshta, si për shkak të vendbanimeve dobët të ndërtuara, si për shkak të mungesës së masave mbrojtëse nga ujërat e mëdha por edhe për shkak të rrënimet moral e shoqëror të tyre. Muslimanë të vdekur në Filipinë, Indonezi, Kosovë, Bosnjë, Çeçeni, Tajlandë, Sudan, Somali, Kinë, Irak e Afganistan .Muslimanët duhet të ndihmohen, së paku pasojat të mbulohen më lehtë. Kemi për detyrë që ta dëshmojmë solidaritetin islam aq shpesh të përmendur mes veti, si në nivelin lokal ashtu edhe në atë global. Muhammedi a. s. thotë: *“Kush ia lehtëson besimtarit vështirësinë në këtë botë, Allahu do t'ia lehtësojë atij vështirësinë në botën tjetër. Ndiha e Allahut do të zgjasë deri sa njeriu e ndihmon vëllanë e tij.”* (Buhariu dhe Muslimi).

Në këtë na nxitë edhe Allahu i madhërisëm në Kur'an: *“Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në të mbara....”* (El-Ma'ida, 2).

Kujtohuni kur baballarët tanë dhe ne para disa vitesh prisnim ndihmat e të tjerëve, kur ishim të uritur e të frikësuar. Muhammedi a.s. ka thënë: *“Nuk është prej neve ai që fle i ngopur, kurse fqinji i tij është i uritur kurse ai e di këtë.”*

Allahu na ndihmoftë në punë të mira, kurse të dëmtuarve mirëqenie dhe kthim besimit të mirëfilltë.

**Përgatiti: Nexhat Ibrahim**

Vijon nga fq 1

Perëndimi i quan terroristë. E vërteta është se bëhet fjalë për të njëjtin model që u përdor nga mediat perëndimore, kur penalizuan fitoren e Hamasit në zgjedhjet e fundit në Palestinë, ku vota e lire e popullit, u penalizua si votë terroriste. Janë pikërisht mediat ndërkombëtare që sajuan edhe një rrezik tjetër potencial që sjell presidenti i ri për Turqinë laike, cili e paska gruan të mbuluar me shami, që në fakt është një gjysmëshami muslimane, sepse shamia e zojës Gyl nuk i plotëson parametrat e shamisë, që duhet të mbajnë femrat muslimane, sepse ajo mbulon flokët dhe le jashtë pjesë të trupit që femra muslimane e ka të detyruar që t'i mbulojë. Por, edhe kjo shami e cunguar, në kokën e zojës Gyl, i tmerron qendrat antiislame ndërkombëtare, që po përpiqen t'i vendosin një lak në qafë, pa e filluar detyrën, presidentit të ri të Turqisë i cili u votua në një parlament të votuar me votën e lire të popullit, duke ua sjellur mendjen vërdallë "Baballarëve të demokracisë" që

duan të montojnë nëpër botë qeveri kuisligje të cilat duhet të jenë në një linjë me këto qendra antislame që, vetëm duke qenë të tilla këto qeveri mund të çertifkohen si qeveri ku "Lulëzon demokracia e vërtetë "Alla perëndimore"! . Askush nuk u habit, kur vuri re se edhe mediat shqiptare mrenda Shqipërisë londineze, iu bashkuan korit antiGyl, sepse këto media janë bërë bisht i një propogande antiturke që shpërtheu ashpër, kur mediat shqiptare u egërsuan se qeveria shqiptare ia dha Albelekomin një firme turke, veprim, që është qartë në interesat e qytetarit shqiptar. Mediat shqiptare hodhën teza shumë denigruese dhe paralajmëruese ndaj qeverisë së re të kryeministrit Erdagon dhe të presidentit ti ri të Turqisë, duke u kujtuar se ushtria turke është kundër presidenti Gyl dhe se kjo ushtri ka rrëzuar katër qeveri dhe se presidenti Gyl po rrezikon laicizmin në Turqi. Për mediat shqiptare dhe të huaja, ky ishte presidenti i vetëm musliman, pas fitores së Ataturkut, në Turqi. në një kohë që dihet se në Turqi nuk ka pase asnjë të krishterë në

historinë e saj si republikë. Shqiptarët, që janë miq. me popullin turk, nuk i shqetëson, por përkundrazi e përshendet fitoren e z. Abdulla Gyl, si president i Turqisë. Ne nuk na shqetëson aspak shamia islame e zonjes së pare të Turqisë, sepse ajo nuk është helmata e ushtarëve nazistë, por është një zgjedhje e lirë e zonjes Gyl e cila, permes një deklarate në media, tha se mbajtja apo jo e shamisë është një çështje e saj personale.

Vitet që do të vijjnë pas, do të tregojnë sa e drejtë dhe sa e rendësishme ishte vota e qytetarit turk, i cili i dha të drejtën të qeverisë politikanit shumë të suksesshëm, Taip Rexhep Erdagan dhe Turqia e Fuqishme të këtë president figurën politike aq popullore në Turqinë Z. Abdulla Gyl..

**Selim Gokaj  
Shkoder, me 31 Gusht 2007**

Viti 1979 n historin m t rebot ore dot mbetet ish uarsi vit i rilindjes fetare t mysliman e n bot n fund t shekullit XX pas nj periudhe ngecjeje nj shekullore. Ky vit sh oi nj kthes t madhe n ndjenjat islame dhe se ishte katalizator i ringjalljes s ndjenjave t n k bura fetare gjer n at koh t mysliman e anemban bot .

Viti 1979, isha n mosh 16 vje re, nx n vitin e par t gjimnazit, kur si vet im p shkroi globin jehona e ngadh jimit t revolucionit islamik n Iran, me rast u shemb dinastia mij je re n krye me shahun Reza Pahlavi si dhe ardhja e imam Homeinit n krye t revolucionit islamik si udh eq politik dhe shpirt or i tij .Kjo me t v tet qe ngjarje e madhe n bot islame dhe se sh beu si pik isje e rilindjes fetare islame pas gati nj shekull stagnimi me rastin e p mbysjes s Perandoris osmane n vitin 1923 dhe rr j pothuajse t t bot islame n kthetrat e pushtimeve kolonialiste. Slogani m ip hapur n at koh ishte Allahu ekber, Homeini rehber q do t thot Allahu ht i madh, Homeini udh eq , kjo klithje e fuqishme b i jehon n t kat an e bot islame. Edhe pse doktrina shiite dallohet nga doktrina sunite, n k koh ngadh jimi i revolucionit islamik n Iran, sh beu si inspirim i masave t shumta t n k bura myslimane n t bot islame. Medoemos edhe kjo klithje e p masave bot ore u reflektua edhe n Kosov me rast n xiti t rip t itjen e ndjenjave fetare n at koh edhe pse ishte koha e sundimit vet everis socialist t ashtuquajtur n at koh n ish Jugosllavi.

Pionier i rip t itjes s k yre ndjenjave fetare n Prizren ka qen myftiu i fundit Hafiz Safet Basha (Allahu e shp bleft me xhenet) i cili nd mori nj iniciativ p at koh e panjohur n mesin ton gjer at er organizoi tubimet javore n lokalet e Vak it

# RILINDJA FETARE

(Myftinis t Prizrenit me t rinjt entuziast besimtar t pak n at koh Tubimet javore rinore zgjat pothuajse 1 vit t plot me rast edhe numri i t rinjve musliman shtohet, edhe pse pothuajse mbaheshin n gjys ilegalitet larg syve t opinionit. Temat q shoshiteshin dhe trajtoheshin ishin kryesisht fetare por nuk anashkaloheshin edhe problemet politike, sidomos pozita e mysliman en shtetet socialiste(komuniste) t asaj kohe, e



sidomos pozita dhe problemet e mysliman en hap ir e ish Jugosllavis n Kosov Maqedoni, Sanxhak, Bosnj e k htu me rrall K o takime t rregullta javore rinore vazhduan gjer n vdekjen e marshall Titos kryetar i p jetsh i ish Jugosllavis dhe udh eq i revolucionit socialist nga viti 1945 e gjer n vitin 1980. Pas vdekjes s Titos me k kes t myftiut, i cili posedonte nj urt i t rall dhe nj strategji veprimi t duhur, edhe pse sado kudo kishte nj liri fetare n at koh por ajo ishte n kontroll dhe mbik yrje t rrept t sh bimit t sigurimit t brendsh (UDB-a).

Myftiu ishte largpam n at drejtim dhe nuk kishte d hir q neve t rinjve t na ndodh ndonj befasi eventuale e

pak dshme n at drejtim. Merita e tij e pamohueshme ishte v ia e bazamentit t k aj rilindjeje

fetare rinore dhe e cila m tutje vet sa e p forcohej m shum Pas k aj aksioni i par i yn konkret rinor ishte renovimi dhe rregullimi i t ish i xhamis s Myderis Ali efendis e cila gjendet p ball kish katolike, dhe se nj koh gjat ishte e braktisur dhe ka sh byer si depo n at koh dhe m par qe e djegur. Me aksionet tona vullnetare dhe ndihm materiale t besimtar e arrit ta kthejm xhamin n sh bim t vet, dhe se kjo ishte xhamia e par n

Prizren e rinovuar pas nj periudhe t gjat mbi 30 vje re t stagnimit t aktiviteteve fetare. Aktiviteti yn i ardhsh vazhdoi tani n xhamin rinovuar me rast organizonim takimet tona, e sidomos gjat net e t Ramazanit, ku vazhdoi ngritja dhe inspirimi yn p klauzol islame. N vitin 1983 u kurdis procesi i montuar n Sarajev kund grupit t intelektual e mysliman n krye me udh eq in e saj Alia Izetbegoviq, i cili proces b i jehon t madhe n t ish Jugosllavin si dhe n aren nd komb are t asaj kohe. Ky proces sh beu si katalizator i ringjalljes s ndjenjave fetare t masave t gjera n Bosnj e m von

gjat viteve 90-ta edhe t ndjenjave komb are t tyre me rastin e shp b jess ish Jugosllavis dhe se ky grup i intelektual e u vu n krye t l izjes dhe rezistenc s armatosur kund agresionit serbomadh mbi Bosnj e Hercegovin . Gjat koh sa zhvillohej procesi i montuar kund grupit t intelektual e mysliman, isha n sh bim ushtarak, dhe se me v endje t madhe e p cillja n mes shtypit t at ersh dhe mjeteve t informimit, pasi n at grup ishte edhe shoku im nga Sarajeva n hetime, por pasi q ishte i mosh jomadhore u lirua pas 30 dit et kaluara n paraburgim. Vend tubimi i mbledhjes s shk dijave t para t ndjenjave

# Viti Orvellian i Ismail Kadaresë

Olsi Jazexhi

Viti 1985 ka qenë një nga vitet më të zymtë për komunistët shqiptarë. Në këtë vit kur Shqipëria humbi 'Vëllain e Madh,' ministri i vetëshpallur i Ministrisë së të Vërtetës pranë Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Ismail Kadareja, shkroi romanin 'Viti i mbrapshtë'. Kush e ka lexuar romanin '1984' të George Orwellit e ka pak a shumë parasysh se cili është misioni i Ministrisë së të Vërtetës në shtetin e ANGLOSOC-it. Funkzioni kryesor i kësaj ministrie ishte rikrijimi i të shkuarës duke e furnizuar popullin me gazeta, filma, libra shkollorë, programe televizive, drama, letërsi ose argëtim për të krijuar një të vërtetë fikzionale, të cilën populli duhej ta pranonte si të vërtetë. Në shtetin e Anglosocit, 'Vëllai i Madh' paraqitej si udhëheqës dhe mbrojtës i Revolucionit qysh prej fillimit të kohës. Ama përveç këtij, punëtorëve të Ministrisë së Vërtetës ju duhej që herë pas here të shpiknin edhe heronjë të tjerë, siç ishte për shembull rasti i shokut Ogliv, i cili vdes në betejë në rrethana heroike duke mbrojtur Anglosocin, dhe legjitimizuar kështu një vijimësi ideologjike të betejës mesianike të 'Vëllait të Madh' në mbrojtje të vatanit.

Unë nuk jam i sigurt nëse Ismail Kadareja e ka pat lexuar romanin '1984', në vitin 1985, kur edhe shkroi romanin 'Viti i mbrapshtë.' Por skenat e romanit 'Viti i mbrapshtë' që mua m'u desh të rilevoj këto ditë, i ngjajnë pak a shumë përrallave të romanit orvellian '1984'. Fakti që më shtyu ta rilevoj romanin 'Viti i mbrapshtë,' për të cilin kam shkruar edhe më parë, ishte një konferencë shtypi që Ismail Kadareja bëri me regjizorin franko-shqiptar, Fatmir Koçi këto ditë në Tiranë. Fatmiri që ka siguruar një shumë të madhe parashë nga kompania Ciné-Sud Promotion në Francë dhe disa organizma të tjerë në Gjermani dhe Belgjikë, duke patur edhe Kadarenë në krah, njoftonte në media në mënyrë triumfaliste se planifikon të bëjë një film i mbështetur mbi romanin 'Viti i mbrapshtë'. Filmi do të quhej 'Viti i Kometës'. Nga sa kuptova nga disa faqe të internetit kompania Cine-Sud është një nga ato shtëpi botuese zhgarravina të Francës që prodhojnë filma propagandistikë për vendet ku Franca ka bërë historikisht pislleqe dhe tani mundohet të ruaj influencën e saj. Kështu disa nga prodhimet kryesore të kësaj kompanie ishin edhe filmi "Tirana Year Zero" ( prodhim franko/shqiptar drejtuar nga Fatmir Koci), filmi "Rashida" (prodhim franko/algjerian drejtuar nga Yamina Bashir), filmi boshnjak "Fuse" etj.

Duke ju kthyer romanit 'Viti i mbrapshtë' të Ismail Kadaresë, fikcioni i tij nis me ngjarjen e kalimit të Kometës Halley pranë tokës në fillim të shekullit të XX-të. Por edhe pse Kometë Halley ka kaluar në 1910, Kadareja problemën e saj e lidh me vitet 1913 1914, kohë kur habsburgët dhe italianët, duke marrë shkas nga dobësia e Perandorisë Osmane, duan që të bashkojnë dy krahinat osmane të Gegërisë dhe Toskërisë dhe me ato formojnë një shtet të ri. Por përkundër fakteve historike të asaj kohe, Kadareja, siç ndodh rëndom në romanet e realizmit socialist, kërkon që në këtë aksident historik ku dy fuqi të mëdhaja ndërtojnë një shtet tip Ruritania kërkon që të gjejë armiq të, miqtë, të mirët dhe këqijtë e vendit. Duke qenë se tamam si në romanin '1984' historia dhe arti duhet të shërbejnë për të legjitimizuar sundimin e Vëllait të Madh, edhe në rastin konkret, shkrimtari, historinë e vitit 1914 e projekton në të tashmen, për të legjitimuar në vitin 1985 sundimin e Vëllait të Madh dhe klanit të tij nga Gjirokastra, ndërsa në ripunimet e mëvonshme, vazhdimin e sundimit post-komunistëve në Shqipëri.

Shqipëria e viteve 1914 ka qenë një fushëbeteje, ku si në të gjithë Evropën kacafyten turlifarë ushtrishë. Asnjë bir nëne që jetonte në këtë copë tokë që prej qindra vitesh, nuk e dinte se çka do të bënin habsburgët dhe italianët me dy krahinat e pushtuara turke të Adriatikut. Agjenturat frënge, serbe, ruse, austriake, greke, italiane dhe trupat e tyre që lëvrinin në Shqipëri në këtë kohë kishin ngritur banda e mercenarë kudo. Për personat që janë profesionistë në histori e dinë shumë mirë që shumica e banorëve që jetonin në Shqipërinë e kësaj kohe dhe ishin myslimanë, veten e tyre e shihnin ende si shtetas të Perandorisë Osmane, pasi siç Ernest Gellneri do ta kishte përkufizuar, koncepti i kombit dhe Shqipërisë sipas aksiomave nacional-komuniste nuk ishte shpikur ende.

Megjithatë, ashtu si në shtetin orvellian, edhe këtu, Ismail Kadareja pretendon që kombi real-socialist



ishite njësi politiko historiko gjeografike e mirëditur dhe ata që mendojnë ndryshe janë armiq. Duke dashur që të përdorë të shkuarën për të legjitimuar të tashmen, në Shqipërinë e vitit 1914 Kadareja prodhon edhe protoherojtë e saj, të cilët ashtu si shoku Ogliv në romanin '1984' janë gati të vdesin dhe luftojnë për tu përkujtuar me madhësi më pas në fjalimet e Vëllait të Madh.

Duke qenë se vetë Kadareja por edhe Vëllai i tij i Madh, Enver Hoxha, janë që të dy jugorë - gjirokastritë, në roman, herojtë që autori krijon për Shqipërinë, lokalizohen në Jug të vendit. Tamam si në shtetin Orvellian, autori është i kujdesshëm të shpikë një gjuhë të re dhe patriotike për vatanin socialist ku herojtë nga Toskëria duhet të kenë të gjithë emra kuptimplotë dhe politikisht korrekt me emrat që Partia e Punës kërkonte që shqiptarët në Epokën e Realizmit Socialist të mbajnë. Herojtë e 'Vitet të mbrapshtë' kanë të gjithë emra politikisht të pastër nga 'barbarizmat turke orientale' dhe pak a shumë përmbajnë kombinacione emrash që ose lidhen me viset trimërore të komunistëve të jugut gjatë Luftës së Dytë Botërore, ose kanë kombinacione emrash herojshe ortodoksë, vllahë dhe bektashianë që luftuan në krah të shokut Enver, apo që partia i shpalli heronjë të kombit.

Herojtë e romanit 'Viti i mbrapshtë' quhen Shestan Verdha, Alush Gjata, Doskë Mokrari, Tod Allamani, Xhemal Lufta, Hysmë Shteti, Nase Shmili, Arif Skamja, Cute Bënja, Llaz Mandili, Gjergjan Vaja, Aleks Belshi, Prift Stilianin dhe Andre Kosturi. Herojtë nisin udhëtimin e tyre legjendar nga jugu i Shqipërisë. Ata e njohin mirë situatën politike në vend, dhe me një pjekuri patriotike formësojnë trupën e tyre atdhetare të njohur si 'forca mokrare' dhe nën udhëheqjen e Shestan Verdhtës nisin marshin për të mbrojtur Shqipërinë. Rrugës drejt veriut të Shqipërisë, luftëtarët mokrarë i prët populli. Si në filmin 'Nëndori i Dytë', në vendin e quajtur Shtatë Krojet psh. gratë e katundit i dhurojnë Shestanit një flamur kombëtar të qëndisur me dorën e tyre. Rrugës, herojtë e romanit takohen me turlifarë njerëzish, ndërmjet të cilëve edhe me trupat franceze të cilat Kadareja në ribotimin e librit në 2003 pasi është bërë shtetas francez i trajton si njerëz që i deshën të mirën Shqipërisë, por që nuk u morrën dot vesh me 'forcën mokrare' si pasojë e moskuptimit në komunikim. Me gjithë peripecitë e rrugës, autori e mbyll përshkrimin e udhëtimit të mokrarëve drejt bërjes së Shqipërisë me një lutje nga prifti ortodoks Stilianin, i cili murmuriste 'Zot mbroje Shqipërinë'.

Ndërsa toskët janë herojtë e 'Vitet të mbrapshtë', në anën tjetër hasmit e kombit Kadareja i projekton në Shqipërinë e Mesme dhe veriore, apo pak a shumë në Gegëri. Urrejtja dhe racizmi anti-gegë i Ismail Kadaresë të cilin ai e ka treguar edhe në një intervistë dhënë ditores së Tiranës «Shekulli», në 3 korrik 2006, kur tiranasit i quan 'kolonë turq', lexohet që në fillim të librit. Kadareja e përshkruan Shqipërinë e Mesme dhe veriun e

Shqipërisë si një vend të egër ku rrojnë kafshë dhe jo njerëz. Një krahasim kaq të egër dhe racist kundër gegëve unë kam mundur të gjej vetëm te njerëzit e egjër, skithët e Rusisë, në Rihlën e Ibn Fadlanit, të portretizuar në filmin 'Luftëtari i Trembëdhjetë' ku rusët shfaqen si kanibalë që udhëhiqen nga një burrë që i duket vetja se është ari. Pak a shumë të njëjtin trajtim merr edhe Gegëria e Ismail Kadaresë e cila jo vetëm se është anti-shqiptare dhe filoturke, por sundohet edhe nga disa njerëz gjysëm bishë:

... në pyjet e Mamurrasit zderhaleshin bandat e Tur Kusarit, dhe më tej ushtria veriore me tirq të zinj e Uk Bajraktarit... ndërsa bandat myslimane të Esad Pashës që kërkonin rikthim te Turqia, vinin vërdallë në Shqipërinë e Mesme nën zhurmën e lodërtive, britmave 'Dum Babën'... dhe duke kënduar si në dergjë këngë të zymta:

Për xhenet u nisëm, sosëm në xhehenem  
Shqipëri moj kuçkë, ç'na bëre verem (fq. 12)

Për Kadarenë, në Gegëri rrojnë disa lloje kafshësh të egra me dy këmbë të cilat jo vetëm që nuk duan kombin, por janë edhe të degraduar moralisht. Gegët të cilët rrojnë në ish-vilajetet myslimane, Kadareja i ndan në disa derexhe, ku më të poshtrit e tyre duken që janë islamikët. Këta udhëhiqen nga dy komandantë kryesorë, Esad Pasha dhe Haxhi Qamili. Këta gegë që Kadareja i ngjyros si armiq të qytetërimit janë të pakuptueshëm nga ushtritë evropjane dhe kapter Vilhelm Vidi, princi kukull që austriakët i vunë Shqipërisë.

Për Kadarenë, pushtuesit evropjanë të vitit 1914 nuk duket se janë në Shqipëri për të copëtuar atë, por përkundrazi për ta qytetëruar. Ama evropjanët që përballen me një popull egërsirash që janë myslimanët shqiptarë, kanë probleme me të kuptuarit e gegëve që kanë emra UK (Ujk), Tuç, Kus Baba, Tur Kusar etj. Një rast moskuptimi Kadareja përmend psh. kur esadistët fanatikë që austriakët duan ti rrethojnë, shpëtojnë pasi austriakët kujtojnë se ka ardhur muaji i Ramazanit, ndërsa esadistët që e kuptojnë moskuptimin e muajve islamë nga austriakët, brohorasin duke thënë:

Allahu na shpëtoi.

Një nga faktorët kryesorë nëpërmjet të cilit Kadareja justifikon barbarizmin e gegëve është vetë feja e tyre, islami. Ndërsa në roman autori të krishterët, të bardhët, evropjanët, francezët, prift Stilianin dhe priftin françeskan Vinçens Marku i tregon si të qytetëruar dhe human, myslimanët që rrojnë nëpër ish-vilajetet myslimane, hoxhallarët dhe dervishët i tregon si hasmit e qytetërimit që kanë çuar gegët në barbari. Anti-myslymanizmi proverbial që shkrimtari franko-shqiptar

Vijon...

Kadare ka shprehur edhe më vonë në librin nga Nëntori në Nëntor, rrëfhet edhe në këtë roman si sëmundja kryesore e anti-qtetërimorisë të shqiptarëve. Islamikët gegë në roman tregohet që arrinin të konfuzojnë edhe vetë evropjanët, të cilët edhe pse kishin futur spiunë të shumtë në mesin e tyre, e kishin të vështirë të parashikonin lëvizjet e myslymanëve esadistëve, pasi këta nuk vepronin sipas ndonjë plani të fshehtë, por sipas ftesave:

*Që baballarët e teqeve u bënë shefave... nga spicat e myftiut të Tiranës... e sidomos nga fallët e Hançe Hamdije Pezë e Madhe, një fathënese e re muslimane e cila kishte parashikuar se Shqipëria... do të mbliidhej kruspull e bëhej sa një portokall. (fq. 47)*

Për të kuptuar sjelljen e gegëve barbarë, në romanin e Kadarese vuan edhe vetë princ Vidi i cili kishte qëndruar një natë pa gjumë për të kuptuar 'pse Haxhi Qamili që shkante gjak e lak si me Esad Pashën, si me serbët nuk bashkohej me të.' Por më fund princ Vidi e kupton që kryetiranasi Haxhi Qamil ishte një i ikur nga çmendia (fq. 50). Pashpjegueshmërinë e gegëve, Kadareja e projektton edhe në sjelljet e ushtrive tirqzeza veriore të Uk Bajraktarit. Evropjanët ashtu si vikingët në filmin 'Luftëtari i Trembëdhjetë', nuk arrijnë të kuptojnë dot lëvizjet e Ujku Bajraktar dhe malokëve të tij të veshur me të zeza. Por edhe kësaj radhe, Kadareja solucionin e barbarisë e gjen te të krishterët apo më saktë te prifti françeskan Vinçens Marku, që Kadareja e cilëson si 'shqiptar'. Ky arrin të dekodojë sjelljen e gegëve dhe kupton që lëvizjet e forcave të veriut shpjegoheshin nga gjetja e malokëve të një harte të humbur austriake, e cila i kishte magjepsur dhe këta lëviznin sipas saj. Por veriorët tirqzinj të Uk Bajraktarit, më në fund zhduken në roman kur përlëshen me ushtrinë e principatës së Mirditës, ku të dy tributë e egra gege humbin nëpër thellësitë e bjeshkëve të Gegërisë për të mos dalë më. (fq. 50)

Kadareja si të egër dhe anti-civilizuese nuk tregon vetëm sjelljen e gegëve, fenë islame të shqiptarëve, mosdashurinë e tyre për t'u bërë evropjanë, mospranimin e një princi kristjan dhe dëshirën e tyre për të ndejtur me Turqinë. Egërsinë, gegëve Kadareja ua fut edhe në emrat e tyre dhe vendeve nga ata vinë. Emrat që ai u jep atyre janë Rrem Qorr-Mehmeti, Tur Kusari, Ali Haxhija, Lalë Vuthi, Shaqir Aliu, Musa Muhtari, Tuç Osmani, Uk Bajraktari, Zija Beqiri, Hasan Zyberi, Hançe Hadije Pezë e Madhe, Mazllum Agaj, Ceno Beu, Haxhi Dervishi etj. Ndërsa për lider kryesor të gegëve Kadareja vendos Kus Babain. Edhe pse Kus Babai është një shenjti i rrespektuar i bektashizmit, në teqen e të cilit në Vlorë shkojnë më mijëra besimtarë nga e gjithë Shqipëria sot, për Kadarenë, Kus Babai i cili edhe këtu është dervish bektashian, është i dhënë keq jo vetëm pas nderimit të Babë Sulltanit dhe urrejtjes ndaj Shqipërisë, por në veçanti ndaj pederastisë. Kadareja, Kus Babain e paraqet si një dervish që lëngon në teqen e tij gjithë ditën për vdekjen e dylberit të tij, Vasillaqit.

Kadareja tregon si të egër edhe vendet nga vinë gegët islamikë. Emrat që ai përmend për vendet e ish-vilajeteve myslymane ku rrojnë esadistët janë Qishbardha, Zall-Herri, Rrashbulli, Zall-Bastari, Dumreja. Gegët me në krye Kus Babain që nuk duan Shqipërinë por Turqinë betohen se:

*po qeder mos kini djema, sa shqitet mishi nga thoi aq shqitet Shqipëria nga Turqia, gjaku do të derdhet gjer në gju të kalit si në Qorrbela, dhe një dervish përmendi yllin me bisht, kometën, si i thoshin kaurët, që ishte shenjë e Allahut...*

Gegët dhe në veçanti esadistët; që gjirokastriti Kadare i portretizon në terma orientaliste si e kundërta e toskëve të civilizuar që janë superiorë dhe kristjanë, duan Shqipërinë dhe udhëhiqen nga prifti ortodoks Stilian nuk e duan Shqipërinë. Ndërsa toskët kudo që luftojnë përmendin Shqipërinë, në gojën e gegëve myslymanë, qafiri Kadare vendos fjalët për Allah dhe Pejgamber. Kur përlëshen me mokrarët psh, esadistët Kadareja i portretizon si kanibalë të cilët vetëm në muaj të Ramazanit tërhiqen nga kanibalizmi i tyre. Tironsi esadist që në kapitullin 8 vret 'patriotin' Andre Kosturi, thotë që 'gjynah se ishte muaj Ramazani'...pse... 'do të më shihte po s'ia haja të gjallë mëlçinë bashkë me shprekën' (fq. 59).

Në të gjithë lesh e li-në që Kadareja zhyt Shqipërinë e vitit 1914, qtetërimin e këtij lesh-vendi e

projekton jo vetëm të jugorët por edhe ushtritë evropjane të cilat nuk tregohen si pushtuese dhe kolonizatore të Shqipërisë, por si qtetëruese të zuluve myslymanë shqiptarë. Mercenarët hollandezë të Princ Vidit, Kadareja nuk i quan okupatorë, por 'ushtria e shtetit shqiptar', të cilët ashtu si toskët e Shestan Verdhës janë të vetmit që ju dhimbet Shqipëria. Por tiranasit e Haxhi Qamilit të cilët Kadareja i quan në intervistën e «Shekullit», në 3 korrik 2006, si pasardhës të pushtuesve turq, janë të pacipë. Këta trembin trembin edhe gruan e pushtuesit austriak princ Vidit, Sophi Schonburg Valdenburgun, të cilën Kadareja e quan mbretëreshë e Shqipërisë. Ashtu si gjirokastriti i tij, Kamban Kadareja që në 1914 priti me lule Venizellosin në Gjirokastër, edhe në këtë roman Kadareja ka vetëm lule për gruan e Vidit. Sophi Schonburgun nuk tregohet si një kolonialiste e bardhë që donte me gjithë të shoqin ti hipë në qafë shqiptarëve dhe të ju marrë vendin, por, si një ëngjëlulshë që trembej kur dëgjon që tiranasit, kavajsit, shijaksit, elbasanllitë dhe durrsakët i kanë kërkuar burrit të saj të bëhet synet nëse do të bëhet i pari i Shqipërisë.

Në romanin 'Viti i mbrapshtë,' Kadareja nuk sulmon dhe tallet vetëm me islamin, muslimanët shqiptarë, gegët dhe veriorët. Në këtë roman ai shfaq edhe shenja anti-semitizmi. Kështu psh. në kapitullin 12 dhe 13 ai flet për kurvën e Durrësit, Sara Stringa në shtratin e të cilës kalonin gjithëfarë lloj diplomatësh të huaj. Sara tregohet të bëjë akte të turpshme, si ato që Janulla Rrapit tregonte përpara ca kohësh në gazetën e Shqipërisë që vajza e Kadarese bënte në vitin 1984 me djalë e saj, Renato Rrapin. Megjithatë, çka të tërheq vëmendjen në këtë pjesë të romanit është se Kadareja, i cili për nderin e vajzës së tij internoi një familje të tërë në vitin 1984, këtu, kurvën Sara Stringa ja jep komunitetit çifut. Sara ishte vajza e një vejushe hebreje nga Malta (fq. 91). Projektimi i kurvës së Durrësit te një çifute duket se nuk është një koicidencë. Çifutët, Kadareja i përmend edhe në kapitullin e 20 të librit, ku Isak Agai që është po ashtu çifut tregohet të jetë trafikant droge. E keqja çifute për Kadarenë ndodhet kudo. Kështu psh. dy herojtë e romanit, Shestani dhe Doska vdesin në Çifut Çifligun, i cili tregohet si një vend tersi dhe ndjellëkeq. Kadareja i ngre edhe këngë Shetsanit të vvarë në Çifligun Çifut si më poshtë:

*Pse u ktheve pas në Çifut Çiflig  
Kapedan Shestan  
Në Çifut Çiflig nata është e ligë  
Kapedan Shestan (fq. 119)*

Racizmi anti-semitik, anti-gegë dhe anti-islamik i Kadarese, që është shpalosur edhe në shkrimin e tij 'Identiteti Evropjan i Shqiptarëve', në roman nuk lë mënjanë edhe arixhijtë dhe evgjijtë. Kështu ndërsa arixhijtë tregohen si hajdutë kuajsh, evgjijtë Kadareja i rrëfen si degjenerata sociale që mendjen e kanë te qejfi dhe ahengu.

Deklarata e Fatmir Koçit disa ditë më parë që romani 'Viti i Mbrapshtë' i Ismail Kadarese po bëhet film, mua më ka shqetësuar jashtë mase. Ndërsa në kohë të PPSH-së sulmi dhe zhdukja e grupeve armike dhe jokonformiste, nga aparatçikët komunistë ka qënë detyrë dhe punë e Ismail Kadarese; misioni i të cilit ishte të ndërtojë njeriun e Realizmit Socialist dhe rikrijimi i të shkuarës me realitete fiksonale, promovimi i sotëm i ideve të Kadarese nga kompania Ciné-Sud Promotion në Francë është kriminal. Unë nuk e kam lexuar ende në detaj skriptin e filmit 'Viti i Kometës'. Ama anti-myslymanizmi, anti-gegërizmi, anti-semitizmi dhe racizmi i Ismail Kadarese në romanin 'Viti i Mbrapshtë' mesa di unë, në vende si Franca por edhe Gjermania dënohet me burg.

Historia ka treguar shpesh që Franca përdor standarte të dyfishta kur merret me botën e tretë. Ashtu si gjatë luftës në Bosnje kur ajo mbështeste krimet serbe apo edhe në Ruanda Burundi, edhe në rastin e filmit 'Viti i Kometës', kompania Ciné-Sud Promotion duke prodhuar një film racist dhe anti-musliman si ky, po ndihmon në nxitjen e racizmit, islamofobisë dhe urrejtjes kundër shqiptarëve, gegë dhe muslimanë në kulturën post-komuniste shqiptare. Prodhimi i filmit 'Viti i Kometës' përbën një mbështetje me paratë e taksapaguesëve evropjanë të projektit gjysëm shekullor orvellian të komunistëve në Shqipëri, të cilët, për të legjitimizuar krimet e tyre kundër shqiptarëve, kthyen mbrapsht historinë e një populli të tërë.

## Hixhabi është obligim per motren muslimane

Allahu I Madhërueshëm e dha natën për pushim dhe ditën për gjallërim. Në suren Junuz. Ajeti 67 thuhet; "Allahu e bëri për ju natën që në të pushoni, e ditën të ndritshme (të shihni). Në këtë e vërteta ka argumente për një popull që ndigjon. Nata e errët karakterizohet nga pushimi dhe qetësia. Ndërsa dita e ndritshme nga gjallëria dhe lëvizja e njerëzve. Sot, njeriu lëviz si këmbësor. Por ai lëviz edhe me mjete të sofistikuar që arrijnë kulmin tek udhëtimet e tij planetare. Njeriu është një krijesë aktive ku ai e sheh vehten duke vështruan ambjentin që e rrethon dhe është vlerësues për atë që sheh me sytë e tij.

Të gjithë ne jemi pjesë e këtij ambjenti dhe si të tillë jemi të shqetësuar nga veshjet jashtë normave morale me të cilat sot femrat po e prezantojnë vehten në ambjente familjare dhe në ato publike. Duhet pranuar se kjo veshje e shemtuar ka ecë shumë përpara duke u bërë një rrezik potencial për vetë shoqërinë. Sot, mund të themi se bëhet fjalë, jo më për veshje ekstravagance, por për lakuriqësi që tashmë ka kapur majat. Qëllimi i këtyre femrave, që për fat të keq tashmë janë bërë shume, është që të bëhen më tërheqëse dhe më pikante, duke harruar se me këtë lloj veshje ato marrin pamjen e plotë të femrave të përdalura. Për fat të keq, është pikërisht veshja e tyre e paturpshme që i bën ato të bëhen dhe viktimat të manjakëve të pandershëm. Femrat, sot, janë dhënë më të gjithë forcën e tyre pas të mirave të kësaj bote me qellimin e mbrapshtë për të shijuar të mirat, por më shumë të këqiat e kësaj bote. Por, përjashtimet nuk mungojnë, sepse ne shikojmë femra që veshen në mënyre modeste dhe jashtë parametrave të lakuriqësisë duke na bindur se e keqja nuk ka triumfuar në mënyrë absolute në shoqërinë tone. Ajo pjesë e moralit, që përshkruam më lart dhe që kishte të bënte me veshjen e femrës sot në shoqërinë tone, nuk është spektri i plote i kësaj dukurie, sepse janë motrat tona muslimane që kanë veshur hixhabin duke plotësuar kërkesën e Allahut të madhërueshëm që ato të mbulojnë trupin e tyre. Femra me hixhab është shembull dhe model për të gjithë motrat tona muslimane, të cilat, me hixhabin e tyre, duhet t, i kundërvihen veshjes imorale që po serviret sot në emër të një bote të përparuar dhe moderne. Të gjithë duhet të jenë të bindur se veshja e hixhabin nuk është një teke apo një ego, ose vetëm një dëshirë personale e saj. Veshja e hixhabin është një urdhër i Allahut xh. sh i dhënë 14 shekuj më parë dhe i zbatuar nga femrat muslimane në të gjithë hapësirën ku ato ndodhen.

Në Kur-anin Famëlartë Allahu xh. sh urdhëron e thotë; "O ti Pejgamer! Thuaju grave tuaja, bijave tuaja, dhe grave të besimtarëve le të vejnë shamitë e veta mbi trupin e tyre, pse kjo është më afër që ato të njihen (se ato nuk janë rrugaçe) e të mos ofendohen. Allahu fal gabimet e kaluara. Ai është mëshirues (El Azabë59)

Duke e lexuar me kujdes këtë ajet, ne gjejmë edhe arsyen përse Allahu i madhërueshëm ka urdhëruar mbulesën e femrës muslimane. Qëllimi është që ajo të jetë e ruajtur dhe e distancuar nga lakuriqësia e cila është dukuri e shejtanit që është gjithmonë në lëvizje për ta larguar femrën muslimane nga rruga e drejtë e Allahut duke bërë të pamundurën që ta çojë atë drejt lakuriqësisë dhe drejt imoralitetit. Ne, si



besimtarë muslimanë, ndejmë një kënaqësi të rrallë kur shohim sot, në Shkodrën tone, gra dhe vajza të mbuluara me hixhab, numuri i të cilave po shtohet me shpejtësi, duke treguar se feja islame po bëhet pjesë e pazëvendësueshme e shpirtit të muslimanëve. Nuk është vetëm Shkodra, ku hixhabin e shikon në çdo çast nëpër rruget e saj, por hixhabi po bëhet pjesë e të gjitha hapësirave shqiptare, në qytet dhe në fshat, ku hixhabi spikat sidomos tek vajzat e reja të cilat tregojnë vlerat e kësaj veshjeje që nuk të pengon për të zënë vendin më të nderuar në shoqëri dhe për të qenë pjese e profesionit më të nderuar. Numuri në rritje i grave dhe vajzave muslimane me shami po shtohet me shpejtësi në të gjithë botën si një tregues i saktë i rritjes së përkushtimit ndaj fesë islame në rrallet e grave dhe vajzave muslimane. Nuk janë të pakët çiftet e rinj muslimanë ku një vajzë me shami është pranë një djali të ri musliman me mjekër që është pasqyrë e synetit të Profetit tone, Muhamedit a. s. . Me veshjen, që po prezantojnë vajzat besimtare muslimane. ato po përcjellin për publikun e gjërë moralin e pastër islam edhe për ato çifte që martohen të mbështetur në një moral të dyshimtë dhe pas pak e shohin vehten të

shkurorëzuar.

Por, është për të ardhur keq që grate dhe vajzat muslimane sot janë pre e një diskriminimi i cili po prek të gjitha sferat ejetës. Një muslimane e mbuluar e ka të vështirë të punësohet dhe të jetë nxënëse në një shkollë publike, në një kohe që vajza të zhveshura deri në ekstrem janë të mirëpritura në punë dhe në shkolla publike, duke i dhenë kështu pamjen e vërtetë të moralit të shoqërisë se sotme në vendin tone. Por, vajzat e zhveshura e kanë të caktuar vendin e tyre në xhehne. Këto fatkeqe do të marrin zvarre në zjarrin e xhehneve edhe babane, vëllaunedhe burrin të cilët do të dënohen për indiferentizmin që treguan duke i lënë grate dhe vajzat e tyre të marrin rrugën e degjenerimit. Kurse për grate dhe vajzat besimtare muslimane, Allahu i madhërisëm ka rezervuar xhehnetin me të gjitha mirësitë e tij, sepse ato kanë zbatuar urdhërin e Allahut për të mbuluar trupin e tyre, zbatimi i të cilit u ka siguruar lumturi në këtë jetë dhe do t, u sigurojë lumturi edhe në jetën tjetër.

*Kasem Zylja  
Shkoder, me 28 Korrik 2007*

## NE VITET 90 BOSNJA U BE ARENE E PERDHUNIMEVE MASIVE TE GRAVE MUSLIMANE NGA FORCAT PARAMILITARE TE SERBISE

Ka shumu vite që në një emision special, në Shkodra TV1, u dha një dokumentar ku telespektatori u shokua nga pamjet që tregonin masakrat e papara që u bënë në Bosnje ndaj popullsisë së pambrojtur muslimane nga forcat serbe që u përfaqëuan në këtë masakër nga një larmi e pafund kriminelësh që fillonin nga armata jugosllave e dikurshme dhe përfundonin tek paramilitarët e pamëshirshëm që linin pas vehtes vetëm kufoma muslimanësh. Në një shkrim të botuar te gazeta muslimane e Maqedonisë "Hëna e Re", nga Shaban Aziri, jepen fakte rengjethëse të përdhunimit të grave dhe vajzave muslimane në Bosnje duke treguar se për ato, që po i vinin flakën qyteteve dhe fshatrave boshnjake, ishte normë edhe përdhunimi duke treguar kështu natyrën shtazarake të ushtrive slave, të njohura historikisht për këtë gen kafshëror në trupin dhe shpirtin e tyre (nëqoftë se kanë pasë ndonjëherë shpirt).

Në një linjë me serbët e Bosnjës, kanë qenë edhe trupat e ushtrisë së kuqe në vitet e Luftës së Dytë Botërore. Në një dokumentar të regjizores gjermane, Sanders, në festivalin e filmit në Berlin në vitin 1992 shfaqti një film dokumentar në të cilin tregohet se ushtarët e armatës së kuqe në vitin 1945 kanë përdhunuar në territoret e Polonisë dhe të Gjermanisë Lindore 2 milion femra. . Para kamerave të mediave, dëshmuar plaka, që në ato vite kishin qenë 15-16 vjeçe. Sipas dëshmisë së tyre, ata ishin përdhunuar me qindra here nga ushtarët sovjetikë që ne i dinim se ishin ushtarë model, sepse kështu na edukonte propoganda komuniste filolslla në Shqipëri dhe në ish-Jugosllavi.

Ushtritë agresore në Bosnje duket se nuk ishin të kënaqur me me shkatërrimet e xhamiave dhe të medrezeve të muslimanëve dhe me maskrat e tmerrshme ndaj civilëve të pafajshëm, por ato kishin pikësynim edhe shkatërrimin moral të muslimanëve duke u përdhunuar grate, motrat dhe nënat e tyre. Lexuesi mund të pyesë përse gazeta "Besimtari" lakon thajse në çdo numur të saj ngjarje nga lufta që u bë në vitet 90 në Bosnje. Evërteta është se ato që u bënë në Bosnje kundër muslimanëve janë krime kundër të gjithë muslimanëve në botë dhe janë një kujtesë se ato mund të bëhen nesër kundër çdo bashkësie muslimane edhe në Ballkan, siç u bënë, menjëherë

pas Bosnjes, në Kosovë ku u përdhunuan 5000 motra muslimane.

Ato dëshmitarë që i pane dhe të tjerë që i përjetuan nga dëshmitë e të tjerëve përdhunimet në Bosnje të grave muslimane tregojnë se dhimjet ishin më të mëdha se ato që po ndodhnin në sheshet e betejave me armatën kriminele serbe

Dhunimet nuk ishin vetëm dëshire shtazarake e kriminelëve serbë, por ishte urdhër nga lart, që vepronte sipas një strategjie të paracaktuar, r duke pasë qëllim final të poshtronin femrat muslimane. Mirsada Didoviq një vajzë 23 vjeçe, një nga viktimat e përdhunuar, do të tregojë e tmerruar; "Na dhunuan me qëllim që të mbetemi shtatzanë dhe me përbuzje na flasin se ne duhet të jemë krenare që do të behemi nëna të fëmijëve serbe, Por ne do t, i abordojmë këto shtatzani, sepse ato nuk janë frut i dashurisë, por janë frut i urrejtjes"-do ta përfundojë fjalën e saj Mirsada.

Numuri i këtyre viktimave të pafajshme është i shtriërë në përmasa të mëdha dhe, sipas statistika të përafërta, arrin në 80 mijë, shifër më të vërtetë shumë rënqethëse për çdo njeri të ndershëm. Duke vazhduar të japim fakte për këtë tematikë të dhimshme, Almira Ajanoviq do të tregojë për një tragjedi njerëzore ku ajo vetë është epiqendra e saj. . Atë natë isha duke ndejtur në shtëpi me prindërit e mi, kur papritmas hynë në dhomë dy paramilitarë serbë me thika në duar dhe, kur unë rezistova, më kërcënuan duke më thenë; "Mbylle gojën turkeshe". Pastaj e lidhën babanë dhe mua më përdhunuan para syve të babait i cili në ato momente vetë qante.

"E kam shumë të vështirë ta shikoi më babain dhe t, i dal përpara, pas asaj ngjarjeje të tmerrshme që ndadhi para syve të tij" -e përfundoi tregimin e tmerrshëm Almira Ajanoviq. Por, të vërtetën e hidhur do ta tregojë një viktimë tjetër nga Bosnja martire.

Savleta Ajonoviq, . një vajzë 18 vjeçe, do të pohojë se edhe ajo ka vuajtur si shoqet e saj fatkeqe. Na përdhunonin natë për natë deri në mëngjez dhe talleshin me ne duke na thenë se ishin të urdhëruar të na përdhunonin , sepse ishim muslimane dhe se ne, si muslimanë, ishim bërë shumë dhe, sipas tyre, duhet të shfaroseshim dhe në këto troje duhet të dominojë populli serb.

Lufta në Bosnje ka mbaruar, por pasojat janë përsëri shumë shqetësuese. Shumë nga grate e vajzat e përdhunuar i kanë aborduar shtazanitë e tyre të dhunshme me paramilitarët dhe kriminelët e tjerë serbë që në Bosnjen viktimë ishin të panumurt.

Të tepra fatkeqe i kanë braktisur krijesat e tyre, që janë pasoja të veprimeve të vrasësve të prindërve të tyre, . Disa të tjera e kanë të pamundur t. i rrisin këto krijesa që kanë baballarë dhunues dhe kriminelë Sipas shumë informacioneve që vijnë nga Bosnja, problemi i këtyre këtyre të paligjshme është dhe mbetet për boshnjakët më i rëndë se minat që la pas kjo luftë e egër dhe e pamëshirshme kundër muslimanëve bashnjakë e cila do të pasohej nga masakrat që serbët bënë më pas në Kosovë duke vazhduar njëkohësisht të mbeten kërcënëm i rrezikshëm edhe në këto momente, kur po hidhet në media këtë shkrim, sepse Statusi i Kosovës është një mine me sahat e cila, po shpërtheu, do të jetë edhe një hapësirë tjetër ku motrat tona kosovarë mund të bëhen pre persëri për kriminelët serbë.

**Selim Gokaj  
Shkoder, më 29 Gusht 2007**

### Bordi drejtues dhe bashkëpunëtorët e gazetës

**Vehbi Dani  
Olsi Jazexhiu  
Selim Gokaj  
Bashkim Bajraktari  
Hysen Kazazi**

**Faqosja:  
Gazjon Rusi  
Radhitja:  
Ditmir Gokaj**

*www.gazetabesimtari.com  
e-mail: gazetabesimtari@yahoo.it*

*- Tirazhi 800 kopje -*

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ

## *Bismil-lahi Rrarhmanirr-rrahim*

*Klientë të nderuar! Vëllezër dhe motra muslimane, market "ISMETI" ju garanton:*

- 1- *Produkte mishi hallall si: sallam, suxhuk,*
- 2- *Pizeri hallall*
- 3- *Fast Food hallall*

*Adresa: Pranë teatrit "MIGJENI"*  
*Cel: 0692101893*



EJANI TEK NE! FABRIKA E PERPUNIMIT  
TE DRURIT

## ILIRIA

me pronar Haxhj Ilir Muja (aktivist dhe bampirës Islam), ju afroon prodhime nga me" të thjeshtat deri ne dhoma gjumi. Shërbehet ne kohe dhe me cilësi të larte:

- Prodhim dyer e dritare
- Dhoma gjumi
- Pajisje zyresh
- Pajisje kuzhine
- Dhoma fëmijësh

Pajisje për ambiente lokalesh  
Te gjitha këto me çmime konkurruese dhe me transport të garantuar falas. Ejani në fabrikën tone dhe do te mbeteni te kënaqur. Mund te kontaktoni me numrin e mobilit: 0692523565

